

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLGGOC			
GLLGGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	08.05		2020
Nj. Org.	Numër	Shifra	Vlera
13-	111-	15240	



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA- DRENAS
DREJTORATI PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE
EMERGJENCË
Dt.08/05/2020



Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-179, për Transportin Rrugor, nenit 15, paragrafi 2, nenit 8, paragrafi 2 i Rregullores për Transportin Rrugor, në territorin e Komunës së Drenasit me nr.06-7086 dhe Vendimit të Kuvendit për miratimin e linjave urbane-periferike në komunën e Drenasit nr. 12-031-14044, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë shpallë këtë:

K O N K U R S

Për linjat Urbano-Periferike të transportit të rregullt të udhëtareve me autobus të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit, për të gjithë Operatorët e licencuar nga Ministria e infrastrukturës, bazuar në ligjit për Transport Rrugor,

Të gjithë Operatorët e transportit rrugorë të udhëtareve me autobus të interesuar që të aplikojnë për linjat si në vijim:

LINJAT :

1. Drenas-Nekoc-Vuqak
2. Drenas-Kizharekë
3. Drenas-Gradicë
4. Drenas-Verboc
5. Drenas-Tërstenik (lagja e Francëve)
6. Drenas-Abri
7. Drenas-Tërdec
8. Drenas-Likoshan
9. Drenas-Shtrubullojë-Krajkovë-Llapushnik
10. Drenas-Domanek
11. Drenas-Sankoc-Fushticë e Epërme
12. Drenas-Poklek i Vjetër-Vasilevë
13. Drenas-Dobroshec
14. Drenas-Polluzhë (lagja Istogu)
15. Drenas-Gjergjiçë
16. Drenas-Godanc
17. Drenas-Shtuticë
18. Drenas-Fushticë e Ulët dhe
19. Drenas-Arllat-Bytyq

Kushtet për aplikim:

1. Kërkesën për aplikim
2. Licencë për transport të udhëtareve me autobus, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës ,
3. Rendin e udhëtimit ku përfshinë : Emrin e operatorit, relacionin, radhitjen e vend-ndaljeve dhe largësinë e tyre nga pika fillestare në km, kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në çdo stacion dhe vend-ndalje, ditët e operimit (periudha kohore në të cilën mbahet linja)
4. Vërtetim më të cilin vërtetohet se nuk është iniciuar ndonjë procedurë e pezullimit apo revokimit,
5. Vërtetimi i lëshuar që vërteton se Operatori Ekonomik nuk ka borxhe të pashlyera të taksës komunale deri në vitin 2019.
6. Vërtetim (jo më të vjetër se 30 ditë nga ATK-ja për kontributet e paguara dëshmi Lista e pagesave për kompanitë, të vulosur nga ATK-ja, së paku në 6 muajt e fundit), kopjet e kontratës së punës, patentë - shoferi-kopje
7. Dëshmi për kapacitetet përkatëse të autobusëve (kopjet e librezave të qarkullimit dhe **certifikatave të autobusëve të noterizuar**).

Mënyra e Aplikimit:

Aplikacioni i plotësuar së bashku me dokumentacionin duhet të dorëzohet në zyrën pritëse-kati i parë , Dokumentacioni dorëzohet në dy kopje, në dy zarfe të mbyllura prej të cilave në njërin duhet të jetë origjinali ndërsa tjetra kopje, të shënuara (të mos hapet).

Komisioni do të zgjedhë Operatorin i cili i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në shpallje publike.

Aplikacionet hapën në lokalet e Komunës.

Aplikacionet e pa nënshkruara dhe të pavulosura nga Menaxheri i Operatorit të Transportit nuk do të shqyrtohen dhe do të konsiderohen si të anuluar.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e shpalljes, nga dt:08.05.2020 deri me 22.05.2020, ora 16:00

Aplikacionet merren në sportelet e zyrës pritëse.

Vërejtje: Në linjën për Godanc do të përshihet dhe të mbahet deri tek Shkolla dhe lagjja Fazliu.

Linja Gjurgjic duhet të hyjë deri tek shkolla në fshat

Linja Arllat-Bytyqt duhet të mbahet deri te vendndalja për autobus në rrugën Mehdi dhe Sylejman Bytyqi në Lagjen Bytyqi

Nisja e fundit prej orës 18:45-19:15, vlen për të gjitha linjat.

